


# NDIKIMI I COVID-19 NË TRANSFORMIMIN DIGJITAL

Transformimi Digjital –  
Shtyllë e Rimëkëmbjes Ekonomike

---

Dhjetor, 2020



# **NDIKIMI I COVID-19 NË TRANSFORMIM DIGJITAL**

Transformimi Digjital –  
Shtyllë e Rimëkëmbjes Ekonomike

---

Dhjetor, 2020

**Autor:** Era Jashari

Këshilltare për Marrëdhëniet me Publikun, Marrëdhëniet Ndërkombëtare  
dhe Zhvillim të Shërbimeve (Oda Ekonomike e Kosovës)  
Certified Digital Transformation Expert

**Design:** Envinion

COPYRIGHT © 2020. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer dhe Odës Ekonomike e Kosovës

# Përmbajtja

---

Hyrje:	6
1. Transformim digjital dhe rëndësia e tij	7
2. Niveli i politikave - skemat aktuale që mbështesin transformim digjital në Kosovë	9
3. Transformim digjital i bizneseve, i nxitur nga Covid-19	11
4. Konkluzione dhe rekomandime - Rruga drejt rimëkëmbjes përmes përkrahjes së digjitalizimit	14

## Hyrje

---

Pashmangshmërisht, ngjashëm me shtetet e tjera të botës, pandemia COVID-19 ndikoi negativisht edhe ekonominë Kosovare, si rezultat i rënies së aktivitetit ekonomik nga mbyllja e ekonomisë. Kështu, Covid-19 ka pasur një ndikim të madh në biznese, shoqëri dhe ekonominë në përgjithësi dhe ka përshpejtuar ndjeshëm nevojën për transformimin digjital të kompanive.

Mes tjerash, Covid-19 ka ndërtuar një narrativë të re për mënyrën e të bërit biznes duke marrë parasysh ndryshimet e shkaktuara për kompanitë e të gjitha sektorëve. Prandaj, është e rëndësishme të diskutohet për mënyrat se si kompanitë të orientohen drejt zbutjes së pasojave ekonomike të pandemisë dhe të përshtaten në përputhje me rrethanat për ti bërë ballë asaj.

Duke e konsideruar Covid-19 si nxitës kryesor të transformimit digjital të kompanive Kosovare, si dhe transformimin digjital si proces të domosdoshëm për kompanitë për të qëndruar relevante dhe konkurrenente në treg, kjo përmbledhje trajton rëndësinë e transformimit digjital si shtyllë për rimëkëmbje ekonomike.

# 1. Transformimi digjital dhe rëndësia e tij

Bota po ndryshon me ritëm të shpejtë bashkë me teknologjitë digjitale të cilat po transformojnë secilin aspekt të jetës, shoqërisë dhe ekonomisë.

Transformimi digjital jo vetëm që ndryshon mënyrën e të bërit biznes ditëve të sotme por krijon në vazhdimësi mundësi të reja për rritje dhe prosperitet për të gjitha segmentet e sektorit publik dhe privat. Transformimi digjital mundëson që bizneset të qëndrojnë relevante në treg dhe të orientojnë strategjitë e tyre kah invacioni duke rritur aftësinë e tyre konkurruese. Transformimi digjital e bën të mundur përdorimin e teknologjisë, njerëzve dhe proceseve për të çuar biznesin përpara.

Megjithatë, transformimi digjital përfshin shumë më shumë se integrimin e plotë të teknologjive digjitale. Transformimi digjital ka të bëjë me transformimin e mendësisë së kompanive në atë mënyrë që përdorimi i mjeteve dhe shkathtësive digjitale të shtojë vlerë dhe të krijojë avantazh konkurrues.

Transformimi digjital mund të përfshijë fusha të tilla si marketing digjital, digjitalizim dhe automatizim të proceseve të biznesit, modeleve të biznesit, kanaleve të shitjes, prokurim digjital, Big Data, dhe procese tjera të ngjashme që lidhen me transformimin shumë dimensional të kompanive.

Sipas autorit David L. Rogers, transformimi digjital ndërtohet mbi pesë sfera të ndryshme përfshirë konsumatorët, konkurrencën, vlerën, inovacionin dhe të dhënat.

## 5 DOMAINS OF DIGITAL TRANSFORMATION



Fig 1. Pesë sferat e transformimit digjital (Rogers, 2016)



Bota po ndryshon me ritëm të shpejtë bashkë me **teknologjitë digjitale** të cilat po transformojnë secilin aspekt të jetës, shoqërisë dhe ekonomisë.

Kjo figurë dhe kombinimi i këtyre pesë faktorëve nënkupton se transformimi digjital nuk ka të bëjë plotësisht me teknologjitë digjitale por me të menduarit strategjik dhe mënyrën se si kompanitë në epokën digjitale duhet ta rimendojnë orientimin e tyre strategjik në pesë fusha si: konsumatorët, konkurrentët, të dhënat, inovacioni dhe vlera.

Në Kosovë ekziston një vetëdije e lartë se digjitalizimi ka rëndësi për biznesin, megjithatë ka ngecje në aspektin e hartimit dhe implementimit të strategjive digjitale. Sektori privat është i vetëdijshëm se digjitalizimi mund ti ndihmojë që të performojë më mirë në të ardhmen, por kompanitë ballafaqohen me barrierë që pengojnë transformimin si mungesa e shkathtësive digjitale të fuqisë punëtore, mungesa e njohurive teknike për ta dërguar përpara procesin e digjitalizimit si dhe mungesa/qasja në financa. Në kuptimin digjital, industria Kosovare është e ndarë varësisht natyrës së punës dhe sektorit të operimit. Mes tjerash, është vënë re se menaxhmenti i kompanive Kosovare mbi të cilët bie barra e digjitalizimit investon më shumë në solucione digjitale, por jo në siguri të TI-së. (OEK, 2019)

Një ndër problemet kryesore në mbarë botën përfshirë Kosovën është se bizneset e kanë të vështirë të përkthejnë transformimin digjital në mundësi për biznesin.

Ekzistojnë arsye të shumta që shpiejnë bizneset drejtë transformimit digjital ashtu siç u përmend edhe më lartë. Megjithatë, në vazhden e pandemisë Covid-19 transformimi digjital për kompanitë Kosovare nuk është opsion por është çështje mbijetese.

Shumë kompani nuk e kanë trajtuar transformimin digjital si diçka urgjente, të paktën jo deri në shfaqjen e domosdoshmërisë për digjitalizim që erdhi si rezultat i pandemisë Covid-19, pjesë e cila do të elaborohet në vijim.

## 2. Niveli i politikave – skemat aktuale që mbështesin transformimin digjital në Kosovë

---

Digjitalizimi vazhdon të mbetet temë 'e nxehtë', e sidomos pas shpërthimit të pandemisë Covid-19 dhe vendosjes së masave kufizuese të cilat dërguan që digjitalizimi të shihet si domosdoshmëri për mbijetesë të kompanive.

Kosova ndër vite përfiton nga skema dhe fonde në përkrahje të transformimit digjital nga BE-ja dhe organizata të shumta ndërkombëtare.

Dihet se lëvizja më e shpejtuar drejt një ekonomie digjitale është parakusht për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, duke konsideruar që transformimi digjital do të shërbejë si një vegël për ta kapur hapin nga aspekti ekonomik dhe social drejt përgatitjes për anëtarësim në BE.

Një ndër iniciativat kryesore në nivelin e politikave për digjitalizimin e ekonomisë së Kosovës është *Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor*. Që nga korriku i vitit 2017, kur u mbajt Samiti i Triestes, liderët e shteteve të Ballkanit Perëndimor kanë njohur zyrtarisht rëndësinë e integritit digjital si një ndër komponentet kyçe të planit të krijimit të Zonës Ekonomike Rajonale (REA). Komisioni Evropian lansoi Agjendën Digjitale në Qershor të vitit 2018 si një ndër gjashtë nismat kryesoret të strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor.


Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor ka për qëllim të mbështesë transformimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në një ekonomi digjitale dhe të sjellë avantazhet e transformimit digjital si rritje më të shpejtë ekonomike, më shumë vende të punës dhe shërbime më të mira.

Agjenda digjitale përfshin shtylla të ndryshme si investimi në infrastrukturë digjitale, ndërtim të kapaciteteve në sigurinë digjitale dhe digjitalizim të industrive, fuqizimin e ekonomisë dhe shkathtësive digjitale, zhvillimin i e-qeverisjes, e-prokurimit dhe uljes së kostos së 'roaming'.

Qëllimi final i kësaj iniciative është të mbështesë Kosovën dhe gjithë shtetet e Ballkanit Perëndimor të kenë sukses në transformimin e tyre digjital dhe t'i përgatis ato më mirë për të ardhmen e tyre të mundshme brenda Bashkimit Evropian.

Agjenda Digjitale mundëson që qytetarët të kenë aftësitë e duhura konform ekonomisë së re, ndihmon në modernizmin e administratës publike, fuqizimin e sigurisë kibernetike, rrit konektivitetin dhe përmirëson klimën e biznesit.





Digjitalizimi vazhdon të mbetet temë 'e nxehtë', e sidomos pas shpërthimit të pandemisë **Covid-19** dhe vendosjes së masave kufizuese të cilat dërguan që digjitalizimi të shihet si domosdoshmëri për mbijetesë të kompanive.

Për më tepër, në tetor të këtij viti Komisioni Evropian miratoi Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë ekonomike me theks në tranzicion të gjelbërt dhe digjital. Gjithashtu, ky plan synon të nxisë integrimin rajonal dhe përafrimin e Kosovës dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian.

Duke u bazuar në *Agjendën Digjitale për Ballkanin Perëndimor*, ky plan investimi ofron një mundësi për të përshpejtuar digjitalizimin e qeverive, shërbimeve publike dhe bizneseve, në përputhje me vlerat dhe kornizën ligjore të BE-së.

Përkrahës të tjerë në ndërtim të kapaciteteve dhe përmes instrumenteve financiare për nisma digjitale janë edhe Banka Botërore përmes projektit KODE (Kosovo Digital Economy) si dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare prezente në Kosovë.

Vlen të theksohet se ekziston një studim bazë mbi digjitalizimin që hulumton 200 kompani nga sektori i prodhimit, shërbimeve dhe agrobiznesit me objektivin kryesor diagnostifikimin e trendeve aktuale të digjitalizimit në sektorët përkatës dhe

identifikimin e nevojave për përkrahje të kompanive. Ky studim është përpiluar nga Oda Ekonomike e Kosovës me mbështetje financiare nga GIZ CETEP në dhjetor të vitit 2019 dhe mund të shërbejë si pasqyrë e përgjithshme e nivelit të digjitalizimit të sektorit privat në vend.

Mes tjerash, Kosova tashmë ka gjeneratën e parë të konsulentëve digjital të cilët kanë ekspertizën për t'i ndihmuar bizneset Kosovare në procesin e transformimit digjital.

### 3. Transformimi digjital i bizneseve, i nxitur nga Covid-19

---

Kaloi pothuajse një vit që kur Covid-19 ndryshoi ekonominë e botës, përfshirë ekonominë Kosovare që vazhdon të mbetet fragile pa një plan të qartë të rimëkëmbjes.

Gjatë pandemisë konsumatorët kanë lëvizur në mënyrë dramatike drejt kanaleve online dhe kompanitë janë përgjigjur në po të njejtën mënyrë.

Pandemia Covid-19 ka krijuar një narrativë të re për mëyrën e të bërit biznes duke marrë parasysh ndryshimet e shkaktuara për kompanitë e të gjitha sektorëve.

Potencialët që ka transformimi digjital për kompanitë janë vënë në dukje sidomos pas shpërthimit të pandemisë së virusit Covid-19 dhe si rezultat i vendosjes së masave kufizuese për parandalimin e perhapjes së tij. Bizneset Kosovare, qofshin ato të vogla, të mesme apo të nivelit korporativ, janë përballur me ndryshime të shumta në mënyrën e të bërit biznes si dhe kanë gjetur veten në një situatë të paprecedent që medoemos kërkon reagim dhe ndryshim.

Kompanitë, të gjendura në këtë pozitë të pazakontë, kërkojnë mënyra për përmirësuar produktivitetin, për të pasur shërbime sa më të mira për klientët, të lehtësojnë komunikimin dhe qasjen tek konsumatorët përmes kanaleve të reja të shitjes. Mes tjerash ato duhet të punojnë për të optimizuar procesin e punës si dhe thjeshtë për të qenë inovativ dhe për të krijuar avantazh konkurrues, si opsion i vetëm për të qëndruar relevante në biznes.

Rrjedhimisht, Covid-19, ka nxitur procesin e transformimit digjital të kompanive në Kosovë, pa marrë parasysh se a ishin bizneset e gatshme për një transformim të tillë.

Lidhur me këtë, në muajt e parë të pandemisë filloi të qarkulloi në internet pyetja si në vijim që aq sa është ironike tregon të vërtetën rreth gjendjes së krijuar.

#### KUSH UDHËHOQI TRANSFORMIMIN DIXHITAL NË KOMPANINË TUAJ

---



A) CEO



B) CTO



C) COVID-19

Fig. 2. Nxitësit e transformimit digjital në kompani



Pyetja **“Kush e nxiti transformimin digjital në kompaninë tuaj?”**, nën supozimin se përgjigja e saktë është alternativa e tretë **COVID-19**, na bën të kuptojmë se shumë kompani nuk e kanë njohur rëndësinë e digjitalizimit deri në përballjen me rrethanat e reja të krijuara si rezultat i pandemisë.

Pyetja “Kush e nxiti transformimin digjital në kompaninë tuaj?”, nën supozimin se përgjigja e saktë është alternativa e tretë COVID-19, na bën të kuptojmë se shumë kompani nuk e kanë njohur rëndësinë e digjitalizimit deri në përballjen me rrethanat e reja të krijuara si rezultat i pandemisë. Me apo pa dëshirën e kompanive, digjitalizimi është kthyer në domosdoshmëri për të mundësuar që kompanitë, varësisht masave kufizuese dhe rrethanave, të përshtaten me ndryshime të tilla si: puna nga shtëpia, krijim të kanaleve për blerje ‘online’, përdorim të teknologjisë në operimet e përditshme, përshtatje me kërkesat dhe pritshmëritë e konsumatorëve, gjetje e kanaleve të përshtatshme për komunikim dhe shpërndarje dhe ndryshime të tjera adaptuese me situatën.

Teknologjitë digjitale dhe digjitalizimi në përgjithësi vijojnë të jenë në qendër të debatit për shkak të përdorimit të tyre gjatë shpërthimit të pandemisë Covid-19.

Pandemia ka shkaktuar dëm si për konsumatorët, ashtu edhe për bizneset, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit punojnë, shpenzojnë dhe kalojnë kohën e tyre të lirë.

Pandemia Covid-19 i ka shtyrë shoqërinë dhe bizneset tek një pikë ku adaptimi me teknologjitë e reja nuk është më opsion por është domosdoshmëri. Për më tepër, me hapat dhe veprimet e duhura, transformimi digjital mund të shihet si përfitim (edhe pse i vonshëm) si rrjedhojë e pandemisë.

Covid-19 mes tjerash ka ndryshuar edhe vizionin e orientimin e menaxhmentit të kompanive. Në rrethana normale, fokusi i bizneseve është në rritjen e të hyrave dhe pjesëmarrjes në treg, përderisa në këtë situatë të paprecedent bizneset Kosovare po luftojnë për të kontrolluar shpenzimet, mbajtur likuiditetin dhe për të mbijetuar.

Edhe ditëve të sotme, Covid-19 po vazhdon të sjellë krizë për shëndetin publik si dhe krizë me pasoja të rënda ekonomike. Është e rëndësishme që sektori privat drejt rrugës për rimëkëmbje ekonomike, të përfshijë transformimin digjital si mënyrë që ka dëshmuar veten të suksesshme në menaxhim të pasojave që ka sjellë pandemia.

Pas tejkalimit të pandemisë Covid-19, kompanitë do të duhet të konsiderojnë ndikimin që këto ndryshime kanë pasur dhe në vazhdimësi të përshtasin mënyrën se si disenojnë, komunikojnë dhe ndërtojnë vlerën për konsumatorin.

Përderisa kompanitë Kosovare nga faza e reagimit imediat po kalojnë në fazën e zbutjes së ndikimit të pandemisë, nevojiten strategji që ndihmojnë konkurrueshmërinë e bizneseve e për disa strategji që sigurojnë mbijetesën në treg.

Transformimi digjital i ka ndihmuar shumë bizneseve Kosovare për të mbijetuar pasojat e pandemisë dhe në këtë drejtim po flasim për kompanitë të cilat veçse kanë filluar digjitalizimin e tyre para shpërthimit të pandemisë. Një rast i tillë i kompanisë e cila po



**Covid-19** mes tjerash ka ndryshuar edhe vizionin e orientimin e menaxhmentit të kompanive. Në rrethana normale, fokusi i bizneseve është në rritjen e të hyrave dhe pjesëmarrjes në treg, përderisa në këtë situatë të paprecedent bizneset Kosovare po luftojnë për të kontrolluar shpenzimet, mbajtur likuiditetin dhe për të mbijetuar.

kalon më lehtë pasojat ekonomike të Covid-19 ose më mirë themi ishte më e përgatitur për shkak të transformimit digjital të nisur disa vite më parë është kompania e intervistuar me qëllime të këtij punimi. Kompania X (emërohet me simbolin 'X' për arsye të anonimitetit dhe paanshmërisë) është ndërmarrje e cila ofron shërbime profesionale për mirëmbajtje, pastrim dhe renovim për klientë individual dhe biznesor.

Gjatë pandemisë kompania X ka vazhduar operimin e saj në mënyrë të rregullt me përjashtim të periudhës kur ishin vendosur kufizime të lëvizjes, kur kompania ka punuar me staf të përgjysmuar. Kompania deklaroi se ka një rënie prej 15 % të aktivitetit ekonomik krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe pohon se po të mos ishte procesi i digjitalizimit që ka nisur në vitin 2017, rënia e aktivitetit do të ishte më e madhe.

Kompania fazën e parë të procesit të transformimit digjital e ka nisur duke digjitalizuar disa prej proceseve që lidhen me aktivitetet shërbyese që ofrojnë, përfshirë digjitalizimin e procesit të shitjeve dhe administrimin e shitjeve dhe porosive. Gjithashtu, kompania ka krijuar edhe aplikacion mobil me anë të së cilit mund të menaxhohet i gjithë procesi i porosive më lehtë.

Përkundër vështirësive në operim, gjatë pandemisë kompania ka rritur prezencën digjitale duke qenë aktive në rrjete sociale dhe duke mos shkurtuar buxhetin e marketingut.

Sipas kompanisë 'X' digjitalizimi i ka shërbyer shumë gjatë kësaj periudhe duke i ndihmuar të amortizoj rënien në biznes. Si rezultat i digjitalizimit të mëhershëm për këtë kompani nuk ka qenë nevoja të improvizohet me strategji të detyruara nga Covid-19.

Në përgjithësi digjitalizimi për kompaninë në fjalë ka lehtësuar menaxhimin e situatës, përcjelljen e informatave, përcjelljen e porosive dhe menaxhimin e porosive.

Në anën tjetër, shumë kompani nuk kanë qenë të përgatitura në aspektin e digjitalizimit duke mos pasur një plan veprimi apo strategji konkrete para pandemisë. Rrjedhimisht, varësisht nevojave imediate që janë shfaqur, ato kanë reaguar duke hyrë kështu pa menduar në procesin e transformimit digjital. Shumë kompani kanë ndërtuar kapacitetet për punë nga shtëpia, të tjera kanë krijuar kanale të reja të shitjes përmes platformave e-commerce e të tjera kanë ndryshuar modelet e bizneseve duke tentuar të krijojnë vlerë dhe avantazh konkurrues.


## 4. Konkluzione dhe rekomandime - Rruga drejt rimëkëmbjes përmes përkrahjes së digjitalizimit

Padyshim, pandemia Covid-19 ka ndikuar në përsheptimin e procesit të transformimit digjital të kompanive. Pandemia Covid-19 ka pasur ndikim që kompanitë ta trajtojnë digjitalizimin jo vetëm si mundësi shtesë, por realisht ta shohin si zgjidhje për mbijetesë në biznes. Duke e konsideruar digjitalizimin si mbijetesë në biznes, ai nuk është trajtuar si proces i blerjes së një pajisje të re teknologjike por më shumë si proces i transformimit dhe një mundësi e mirë për të zvogëluar kostot e operimit. Mes tjerash digjitalizimi është shfrytëzuar për të përgatitur kompanitë për të qenë më konkurruese në tregjet e brendshme dhe të jashtme.

Megjithatë, bizneset Kosovare duket se e njohin rëndësinë e digjitalizimit mirëpo stagnojnë në hartimin dhe implementimin e strategjive të digjitalizimit dhe planeve konkrete të veprimit. Rrjedhimisht, mund të konkludohet se transformimi digjital është rikthyer si urgjencë për bizneset Kosovare nxitur nga pandemia Covid-19 dhe masat kufizuese për parandalimin e saj. Në këtë drejtim, transformimi digjital duhet të shërbejë si shtyllë për rimëkëmbje ekonomike që mbështetet përmes instrumenteve konkrete financiare dhe modaliteteve tjera.

Tashmë dihet rëndësia dhe nevoja e digjitalizimit të sektorit privat por edhe të administratës publike dhe qeverisë. Agjencia e Statistikave të Kosovës për vitin 2019, deklaroi se depërtimi i internetit në Kosovë është 93% (një nga më të lartët në Evropë). Kjo përhapje e madhe e Internetit në Kosovë mund të shërbejë si pikënisje për më shumë digjitalizim të shërbimeve nga institucionet publike. Megjithatë, Kosova mbetet prapa në shumicën e masave të transformimit digjital, si përdorimi i teknologjisë 'broadband', përdorimi i teknologjive tjera digjitale si dhe gatishmëria digjitale e administratës publike dhe qeverisë.

Në bazë të analizës së të dhënave sekondare dhe studimit të Odës Ekonomike të Kosovës "Digjitalizimi i bizneseve në Kosovë - Status quo, - Sfidat dhe mundësitë" kuptohet se barrierat kryesore për kompanitë që pengojnë procesin e digjitalizimit janë: mungesa e shkathtësive digjitale të fuqisë punëtore, mungesa e njohurive teknike për ta dërguar përpara procesin e digjitalizimit si dhe mungesa/qasja në financa.



**Fig. 3. Pengesat kryesore për digjitalizimin e bizneseve Kosovare (OEK, 2019)**

Është shumë e rëndësishme që të gjithë bashkërisht, përfshirë bizneset, institucionet shtetërore, donatorët dhe akterët tjerë të ndihmojnë në këtë sfidë të rimëkëmbjes ekonomike për bizneset, në funksion të krijimit të një ambienti më të mirë për të bërë biznes dhe rritjen e konkurrueshmërisë të bizneseve Kosovare.

**Për të ndihmuar rimëkëmbjen ekonomike përmes transformimit digjital dhe lehtësuar dëmin që pandemia ka shkaktuar në aspektin ekonomik, kjo analizë e shkurtër ofron rekomandimet në vijim për akterët relevant:**

- Fokus në digjitalizim të administratës dhe të reduktimit të burokracisë;
- Financim të kompanive për digjitalizim të proceseve të tyre biznesore dhe rritje të aktiviteteve biznesore përmes tregtisë elektronike;
- Koordinim ndërinstytucional dhe përgatitje e një plani konkret të punës lidhur me Agjendën Digjitale për Ballkanin Perëndimor dhe Planin për Ekonomi dhe Investime për Ballkanin Perëndimor;
- Harmonizimi i gjithë akterëve kyç për shfrytëzimin sa më të mirë të skemave mbështetëse për transformim digjital;
- Përkrahja e ekspertizës aktuale digjitale në favor të transformimit digjital të sektorit privat dhe shtimit të ekspertizës për digjitalizim;
- Miratimi i pakos së ligjeve që mbështetin digjitalizimin e institucioneve publike dhe sektorit privat;
- Implementimi i fushatave vetëdijësuese për të promovuar digjitalizimin dhe potencialet që i ofron.

